



BPrAL AAB
INSTITUCIONI I ARSIMIT UNIVERSITAR

FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

KONCEPTIMI DHE INICIALIZIMI I PROJEKTËVE TË TI-SË

LËNDA: MENAXHIMI I PROJEKTËVE TË TI-së


Ligjërues: MSc. Artan DRESHAJ

CIKLI JETËSOR I PROJEKTIT DHE ZHVILLIMI I TI

- ▶ Sikli jetësor i projektit (Project Life Cycle - PLC) është një koleksion i fazave logjike që pasqyron jetën e një projekti nga fillimi deri në përfundim të tij, në mënyrë që të definoj, ndërtoj, dhe të paraqes produktin e një projekti - I cili mund të jetë produkt, shërbim apo sistem informacioni.
- ▶ Secila fazë duhet të siguroj një apo më shumë rezultate.
- ▶ Një rezultat është një produkt i prekshëm dhe i verifikueshëm i punës p.sh. Plani i projektit, dizajnimi i specifikacioneve, etj.
- ▶ Projektet duhet të ndahen në faza për ta bërë projektin më të menaxhueshëm dhe për të reduktuar rrezikun.
- ▶ Rezultatet në fund të një faze aprovohen para fillimit të fazës tjetër.
- ▶ Sikurse në jetën e përditshme, projektet kanë ciklet jetësore meqë rast ato lindin, rriten, e arrijnë kulmin, fillojnë rënien, dhe pastaj përfundojnë.

CIKLI JETËSOR I PROJEKTIT DHE ZHVILLIMI I TI

- Një cikël i përgjithshëm jetësor i projektit



CIKLI JETËSOR I PROJEKTIT DHE ZHVILLIMI I TI

- ▶ **Definimi i qëllimit të projektit** - Përcaktimi i qëllimit të përgjithshëm të projektit duhet të jetë hapi i parë. Një qëllim i përcaktuar mirë i jep ekipit të projektit një fokus të qartë dhe i drejton fazat e tjera të projektit.
- ▶ **Plani i projektit** - Pasi që qëllimi i projektit është përcaktuar, zhvillimi i planit të projektit është një detyrë shumë më e lehtë. Rezultatet, detyrat, burimet, buxheti dhe koha për të përfunduar çdo detyrë duhet të përcaktohen për secilën fazë të projektit. Një plan kryesisht jep përgjigje në pyetjet e mëposhtme:
 - ▶ *Çfarë jemi duke dëshiruar të bëjmë?*
 - ▶ *Çfarë nuk jemi duke dëshiruar të bëjmë?*
 - ▶ *Pse jemi duke dëshiruar ta bëjmë atë projekt?*
 - ▶ *Si jemi duke dëshiruar ta bëjmë atë projekt?*
 - ▶ *Kush dëshirojmë të jetë i përfshirë?*
 - ▶ *Sa do të zgjasë projekti?*
 - ▶ *Sa do të kushtoj projekt?*
 - ▶ *Çfarë mund të shkoj keq dhe çka mund të bëjmë rreth saj?*
 - ▶ *Si do të mund të dimë nëse do të jemi të suksesshëm?*


CIKLI JETËSOR I PROJEKTIT DHE ZHVILLIMI I TI

- ▶ **Plani i ekzekutimit të projektit** - Pas definimit të qëllimit dhe përgatitjes së planit, fillon procesi i ekzekutimit. Si po përparon puna mbi projektin, fushëveprimi, orari, buxheti, dhe njerëzit duhet të menaxhohet në mënyrë aktive për të siguruar që projekti të arrijë qëllimin e tij. Progresi duhet të dokumentohet dhe krahasohet me planin bazë. Në fund të kësaj faze, ekipi implementon ose sjell një produkt, shërbim, apo sistem të kompletuar të informacionit për organizatën.
- ▶ **Mbyllja e projektit** - Secili projekt duhet të ketë të definuar fillimin dhe përfundimin. Faza e mbylljes siguron që e gjithë puna është përfunduar siç është planifikuar dhe siç është rënë dakord për të nga ana e ekipit dhe sponsorit. Kjo mbyllje mbulohet shpesh me një raport përfundimtar të projektit dhe prezantimit të klienti që dokumenton se të gjitha rezultatet e premtuara janë përfunduar ashtu siç është specifikuar.
- ▶ **Vlerësimi i projektit** - Ndonjëherë vlera e një projekti të IT nuk dihet kur produkti, shërbimi, apo sistem informacioni është implementuar. Megjithatë, të dy ekipi i projektit dhe vetë projekti duhet të vlerësohet në fund të projektit.

CIKLI JETËSOR I ZHVILLIMIT TË SISTEMËVE


- ▶ Cikli jetësor i zhvillimit të sistemeve (systems development life cycle-SDLC) në TI paraqet të gjitha fazat e një sistemi informativ që i ndjek gjatë gjithë jetës së tij.
- ▶ SDLC krijon një rend logjik në të cilën aktivitetet e zhvillimit të sistemit ndodhin dhe tregojnë se si do të vazhdohet nga një aktivitet i zhvillimit të sistemit në tjetrin.
- ▶ Planifikimi, analiza, dizajni, implementimi, dhe mirëmbajtja dhe mbështetja janë pesë fazat themelore në ciklin jetësor të zhvillimit të sistemeve.
- ▶ Cikli i jetësor i projektit (PLC) fokusohet në fazat, proceset, mjetet, njohurit, dhe aftësitë për menaxhimin e një projekti, ndërsa cikli jetësor i zhvillimit të sistemit (SDLC) fokusohet në krijimin dhe implementimin e produktit të projektit- sistemin e informativ.

CIKLI JETËSOR I ZHVILLIMIT TË SISTEMËVE - 2




METODOLOGJIA E PROJEKTIT TË TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

- ▶ Një metodologji ofron një plan të nivelit strategjik për menaxhimin dhe kontrollin e projekteve të TI-së.



METODOLOGJIA E NJË PROJEKTI TË TI - së



IT Project Management Foundation

PM process groups:	Initiating, planning, executing, controlling, closing
PM objectives:	Scope, schedule, budget, quality
Tools:Infrastructure:	Project management, information systems development
PMBOK areas:	Organizational, project, technical Integration management, scope management, time management, cost management, quality management, HR management, communications management, risk management, procurement management

Faza e parë - Konceptualizimi dhe inicializimi

- ▶ Faza e parë e metodologjisë së projektit të TI-së fokusohet në përcaktimin e qëllimit të përgjithshëm të projektit.
- ▶ Një projekt është ndërmarrë për një qëllim të veçantë, dhe se qëllimi duhet të jetë për të shtuar vlerën e prekshme për atë organizatë.
- ▶ Përcaktimi i qëllimit të projektit është hapi më i rëndësishëm në metodologjinë e projektit të TI-së.
- ▶ Duhet të identifikohen alternativat që do të lejojnë organizatën për të përmbushur qëllimin e saj, pastaj duhet analizuar, kostot dhe përfitimet, arsyeshmëria dhe rreziku, e secilës alternativë.
- ▶ Në bazë të këtyre analizave, një alternativë e veçantë është e rekomanduar për financim.
- ▶ Në fund, qëllimi i projektit dhe analiza e alternativave që mbështesin qëllimin janë përmbledhur në një rezultat i quajtur ngjarjet e biznesit (business case).

Faza e dytë - Zhvillimi i skemës dhe planit të detajuar të projektit

- ▶ Skema e projektit është një dokument kryesor për fazën e dytë të metodologjisë së projektit të TI-së.
- ▶ Ajo përcakton se si do të organizohet projekti dhe se si do të zbatohet alternativa e projektit që është rekomanduar dhe miratuar për financim.
- ▶ Skema e projektit ofron një mundësi tjetër për të sqaruar qëllimin e projektit dhe përcakton objektivat e projektit në terma të fushëveprimit, orarit, buxhetit, dhe të cilësisë.
- ▶ Plani i projektit parashikon të gjitha detajet taktike në lidhje me atë se kush do të kryejnë punët e projektit dhe kur.
- ▶ Skema dhe plani i projektit duhet të përgjigjet në këto pyetje:
 - ▶ *Kush është menaxheri i projektit?*
 - ▶ *Kush është sponsoruesi i projektit?*
 - ▶ *Kush është në ekipin e projektit?*

Faza e dytë - Zhvillimi i skemës dhe planit të detajuar të projektit - (2)

- ▶ *Çfarë roli luan secili anëtar përgjatë projektit?*
- ▶ *Cili është qëllimi i projektit?*
- ▶ *Sa do të kushtojë projekti?*
- ▶ *Sa kohë do të marrë për të përfunduar projektin?*
- ▶ *Çfarë resurseve dhe teknologjive do të jenë të nevojshme?*
- ▶ *Çfarë qasje, mjete, dhe teknika do të përdoren për të zhvilluar sistemin e informacionit?*
- ▶ *Çfarë detyra apo aktivitete do të jenë të nevojshme për të kryer punën e projektit?*
- ▶ *Sa kohë do të marrin këto detyra apo aktivitete?*
- ▶ *Kush do të jetë përgjegjës për kryerjen e këtyre detyrave ose aktiviteteve?*
- ▶ *Çfarë do të përfitoj organizata për kohën, parat, dhe resurset e investuara në këtë projekt?*

Faza e tretë - Ekzekutimi dhe kontrolli i projektit

- ▶ Faza e tretë e metodologjisë së IT projektit fokusohet në ekzekutim dhe kontrollin-realizimit të planit të projektit për të ofruar produktin e IT dhe menaxhimin e proceseve të projektit për të arritur qëllimin e projektit.
- ▶ Gjatë kësaj faze ekipi i projektit përdor një qasje të veçantë dhe të vendosur të analizës së sistemeve dhe mjetet e projektimit për zbatimin e ciklit jetësor të zhvillimit të sistemeve (SDLC).
- ▶ Menaxheri i projektit duhet të sigurojë mjedisin dhe infrastrukturën që do të mbështesë projektin e që përfshin:
 - ▶ *Gjetja e njerëzve me aftësitë, përvojën, dhe njohurit e përshtatshme.*
 - ▶ *Infrastruktura teknike për zhvillimin.*
 - ▶ *Metodat dhe mjetet e zhvillimit të Sistemit Informativ.*
 - ▶ *Një mjedis i duhur punë.*
 - ▶ *Fushëveprimi, orari, buxheti, dhe kontrollet e cilësisë.*

Faza e tretë - Ekzekutimi dhe kontrolli i projektit - (2)

- ▶ *Një plan i detajuar I riskut.*
- ▶ *Një plan i prokurimit për shitësit dhe furnizuesit.*
- ▶ *Një plan i menaxhimit të cilësisë.*
- ▶ *Një plan i menaxhimit të ndryshimeve.*
- ▶ *Një plan i komunikimit.*
- ▶ *Një plan testimi.*
- ▶ *Një plan implementimi.*
- ▶ *Një sistem i burimeve njerëzore për vlerësime dhe shpërblime.*

Faza e katërt - Mbyllja e projektit

- ▶ Pasi që sistemi i informacionit është zhvilluar, testuar, dhe instaluar, një pranim formal duhet të transferojë kontrollin nga ekipi i projektit tek klienti apo sponzori i projektit.
- ▶ Ekipi i projektit duhet të përgatisë një raport përfundimtar të projektit dhe prezantim të dokumentit dhe të verifikojë që të gjitha rezultatet e projektit janë përfunduar siç përcaktohet në fushëveprimin e projektit.
- ▶ Në këtë kohë, kostoja përfundimtare e projektit mund të përcaktohet.

Faza e pestë - Vlerësimi i suksesit të projektit

- ▶ Faza finale e metodologjisë duhet të fokusohet në vlerësimin e katër fushave.
 - ▶ Së pari, një "postmortem", ose rishikim përfundimtar të projektit, duhet të kryhet nga menaxheri i projektit dhe ekipi. Ky rishikim duhet të përqendrohet në të gjithë projektin dhe të përpjekjet për të vlerësuar se çfarë shkoi mirë dhe çfarë ekipi i projektit mund të kishte bërë më mirë.
 - ▶ Së dyti vlerësimi duhet të bëhet në mes menaxherit të projektit dhe anëtarëve individual të ekipit të projektit. Edhe pse kjo përmbledhje e ekzekutimit mund të strukturohet në aspektin e performancës, është e rëndësishme që secili anëtar i ekipit të marrë reagime të ndershëm dhe të dobishme në lidhje me performancën e tij apo të saj për projektin.
 - ▶ Një palë e tretë jashtë duhet të rishikojë projektin, menaxherin e projektit, dhe ekipin e projektit.
 - ▶ Së fundi, projekti duhet të vlerësohet për të përcaktuar nëse projekti ka ofruar vlera për organizatën.

SITUATAT E BIZNESIT - Bussiness Case


- ▶ Një situatë biznesi ofron rezultatin e parë në ciklin jetësor të projektit të TI-së.
- ▶ Ajo ofron një analizë të vlerës së organizatës, fizibilitetin, kostot, përfitimet, dhe rreziqet e disa alternativave të propozuara ose opsioneve.
- ▶ Megjithatë, një studim i situatave të biznesit nuk është një buxhet ose plan projekt.
- ▶ Qëllimi i një studimi të biznesit është që të sigurojë menaxhmentin e lartë me të gjitha informatat e nevojshme për të marrë një vendim të informuar, nëse duhet të financohet një projekt specifik.
- ▶ Për projekte më të mëdha, një studim i situatave të biznesit mund të jetë një dokument i madh, formal. Edhe për projekte më të vogla, një studim i tillë është i dobishëm me qëllim që të dihet se si ai projekt mund të sjellë vlerë në një organizatë.

Zhvillimi i një “Business Case”

- ▶ Qëllimi i një bussiness case është për të treguar se si një zgjidhje e IT mund të krijojë vlera të biznesit.
- ▶ Edhe pse IT projektet mund të ndërmerren për një numër të madh arsyesh, vlera e organizatës përgjithësisht përqendrohet në përmirësimin e efektivitetit dhe / ose efikasitetit.
- ▶ Për shembull, një projekt IT mund të ndërmerren për të:
 - ▶ Zbritur kostot
 - ▶ Krijuar një produkt ose shërbim të ri
 - ▶ Përmirësuar shërbimet e klientëve
 - ▶ Përmirësuar komunikimin
 - ▶ Përmirësuar vendim-marrjen
 - ▶ Krijoj ose të forcojë marrëdhëniet me furnizuesit, klientët, apo partnerët
 - ▶ Përmirësu proceset
 - ▶ Përmirësu mundësit e raportimit
 - ▶ Mbështetet kërkesat e reja ligjore

Zhvillimi i një “Bussiness Case”

► Procesi për zhvillimin e një Bussiness Case



Zhvillimi i një “Business Case”


- ▶ **Hapi I parë: Zgjedhja e ekipit kryesor (qendror)** - Në vend që të ketë një person për të marrë përgjegjësinë i vetëm për zhvillimin business case, një ekip kryesor duhet të rekrutohet.
- ▶ Ekipi kryesor duhet të përfshijë menaxherët, specialistë të biznesit, dhe përdoruesitë të cilët i kuptojnë kërkesat që duhet të plotësohen, si dhe specialistë të TI-së që i kuptojnë mundësitë, kufizimet, dhe rreziqet që lidhen me TI.
- ▶ Në përgjithësi, ekzistojnë disa avantazhe për të pasur një ekip kryesor për të zhvilluar një business case:
 - ▶ Besueshmëria - Një ekip i përbërë nga individë nga fusha të ndryshme organizative apo departamenteve mund të sigurojë qasje në ekspertizën dhe informacion kritik që nuk mund të jenë të arritshme për të tjerët jashtë asaj zonë të veçantë.
 - ▶ Përputhshmëria me qëllimet e organizatës - Menaxherët e nivelit më të lartë mund të ndihmojë të lidhë business case me planin strategjik dhe misionin afat-gjatë të organizatës.

Zhvillimi i një “Business Case”

- ▶ Qasja në kostot reale - Anëtarët kryesor me ekspertizë të caktuar ose qasje në informata të rëndësishme mund të ndihmojë në ndërtimin e vlerësimeve më realiste në fusha të tilla si pagat, kontabiliteti dhe praktikat e raportimit, kërkesat e trajnimit, rregullave të sindikatave dhe rregulloreve dhe praktikave punësimit.
- ▶ Hapi i dytë. Definimi i vlerës së matshme të organizatës (VMO) - Objektiv i ekipit bazë duhet të jetë për të definuar problemin apo mundësin dhe pastaj të identifikojë disa alternativa që do të ofrojnë vlera të drejtpërdrejta dhe të matshme për organizatën. Të ofrojë vlerën reale të një organizate, projektet e IT duhet lidhur me të dhe të mbështesin qëllimet, misionin dhe objektivat e organizatës. VMO duhet:
 - ▶ Të jetë e matshme
 - ▶ Ofrojë vlera për organizatën
 - ▶ Të jetë I pranueshëm për të gjitha palët e interesit
 - ▶ Të jetë I verifikueshëm

Zhvillimi i një “Bussiness Case”

► Zingjiri i vlerës së TI



Zhvillimi i një “Bussiness Case”

- ▶ Identifikimi i hapësirës së dëshiruar të ndikimit - Hapi i parë përfshin identifikimin e ndikimit të dëshiruar që projekti i TI do të luajë në mbështetjen e organizatës.
Pyetja më e rëndësishme që duhet të përgjigjem në këtë pikë është arsyeja pse ne jemi duke menduar për të bërë këtë projekt.
- ▶ Hapësirat potenciale të ndikimit të projekteve të TI-së.

<i>Potential Area</i>	<i>Examples of Desired Impact</i>
Strategic	<ul style="list-style-type: none">■ Penetration of new markets■ Transformation of the terms of competition within the market■ Increased market share
Customer	<ul style="list-style-type: none">■ Customers have more choices of products or services■ Customers receive better products or services■ Transaction processes are more efficient or effective
Financial	<ul style="list-style-type: none">■ Increased profit■ Increased margins
Operational	<ul style="list-style-type: none">■ Lower costs due to streamlined operations■ Increased operational effectiveness
Social	<ul style="list-style-type: none">■ Improvements to supply chain■ Education■ Health■ Safety■ Environment

Zhvillimi i një “Business Case”

- ▶ Identifikimi i vlerës së dëshiruar të projektit të TI-së - Pasi zona e dëshiruar e ndikimit është identifikuar, hapi tjetër përfshin përcaktimin e vlerës së dëshiruar që projekti i TI do të sjellë për organizatën.
Në terma të thjeshtë, mund të identifikojmë vlerën e një projekti të IT, duke ofruar përgjigje për katër pyetjet e mëposhtme:
 - ▶ Më mirë - Çfarë organizata dëshiron të bëjë më mirë?
 - ▶ Më shpejtë - Çfarë organizata dëshiron të bëjë më të shpejtë?
 - ▶ Më lirë - Çfarë organizata dëshiron të bëjë më të lirë?
 - ▶ Të bëjë më shumë - Çfarë organizata dëshiron të bëjë më shumë se sa është duke bërë aktualisht?
- ▶ Zhvillimi i një metrikë (matësi) të përshtatshëm - Hapi tjetër është për të zhvilluar një metrikë që
 - ▶ ofron ekipit të projektit një objektiv apo direktivë
 - ▶ vendos pritshmërit në mesin e të gjitha palëve të interesuara,
 - ▶ siguron një mjet për vlerësimin nëse projekti është një sukses më vonë.

Zhvillimi i një “Business Case”

- ▶ Hapi i tretë. Identifikimi I alternativave - Në përgjithësi nuk ekziston një zgjidhje e vetme për probleme organizative, është e domosdoshme për të identifikuar paraprakisht disa alternativa që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me një mundësi të caktuar të biznesit.
- ▶ Hapi i katërt. Definimi i arsyeshmëris dhe vlerësimi i rrezikut - Çdo opsion ose alternativ duhet të analizohet në aspektin e fizibilitetit të tij dhe rrezikut potencial. Fizibiliteti duhet të shikohet në terme të:
 - ▶ Fizibilitetit ekonomik
 - ▶ Fizibilitetit teknik
 - ▶ Fizibiliteti organizativ
- ▶ Rreziku duhet fokusuar në:
 - ▶ Identifikimi - Çfarë mund të shkojë keq? Çfarë duhet të shkojë drejtë?
 - ▶ Vlerësimi - Çfarë është ndikimi i secilit rrezik?
 - ▶ Përgjigje - Si mundet organizata të shmangë ose minimizoj rrezikun?

Zhvillimi I një “Bussiness Case”

- ▶ Hapi i pestë. Definimi I kostos totale të pronësisë. Vendimi për të investuar në një TI projekt duhet të marrë parasysh të gjitha shpenzimet që lidhen me aplikimin e sistemit. Kostoja Totale e Pronësisë (TCO) është një koncept që i referohet kostos totale të blerjes, zhvillimit, mirëmbajtjes dhe mbështetjen e sistemit të aplikimit gjatë jetës së tij.
- ▶ Hapi i gjashtë. Definimi I përfitimeve të pronësisë - Përfitimet totale të pronësisë (TBO) duhet të përfshijë të gjitha të mirat e drejtpërdrejta, të vazhdueshme, dhe indirekte që lidhen me secilën alternativë të propozuar. TBO duhet të adresojnë të mirat e një alternative gjatë rrjedhës së jetës së tij të dobishme.
- ▶ Hapi i shtatë. Analiza e alternativave - Pasi janë identifikuar kostot dhe përfitimet, është e rëndësishme që të gjitha alternativat të krahasohen me njëri-tjetrin në mënyrë të vazhdueshme. Ekzistojnë disa mënyra për të analizuar alternativat e propozuara. Më të zakonshme janë modeli financiar dhe modeli I pikëve (notimit).

Zhvillimi i një “Bussiness Case”

- ▶ **Modelet financiare** - përqendrohet në të dyja, përfitimet dhe /ose rrjedhën e së parasë. Modelet e rrjedhës së parasë përqendrohet në para të gatshme neto, mund të jetë pozitiv ose negativ, dhe llogariten duke zbritur nga cash dalës nga cash hyrës. Në përgjithësi, mund të shikoni përfitimet që lidhen me një alternativë të caktuar si burim i hyrjeve të mjeteve monetare dhe kostot si burim i daljeve.
- ▶ Modelet më të zakonshme të përdorura të rrjedhës së parasë përfshijnë shpagim (payback), rentabiliteti, kthimi i investimit, vlera aktuale neto, dhe rezultati.
 - ▶ Shpagim (Payback) paraqet metodën që përcakton se sa kohë do të marrë për të rimarrë investimin fillestar. Për shembull, nëse një kompani shpenzon 100,000 \$ zhvillimin dhe zbatimin e një sistemi të aplikimit dhe pastaj merr një kthim të parave të gatshme neto prej \$ 20,000 në vit, periudha shpagim për atë investim do të jetë: periudha e shpagimit = $\frac{\text{investimi fillestar}}{\text{net cash flow}} = \frac{100,000\$}{5,000\$} = 5 \text{ vite.}$

Zhvillimi i një “Bussiness Case”

- ▶ **Rentabiliteti** - Ngjashëm me metodën e shpagimit, metodë e rentabilitetit përpiqet për të përcaktuar pikën në të cilën një projekt do të fillojë të mbledhte investimin e tij origjinal. Për shembull, le të themi se ju do të dëshironi për të krijuar një faqe interneti për të shitur shkopinj të golfi që ju i prodhoni. Nëse keni shpenzuar 100.000 \$ për të krijuar faqen, sa shkopinj golfi do të ju duhet për të shitur për të kthyer investimin në qoftë se ju do të shisni çdo shkop golfi për \$ 30?
- ▶ Për të përcaktuar këtë pikë, ju duhet të shikoni në koston e shitjes së një shkopi golfi. Këto kosto mund të përfshijnë si në vijim:

Materials (putter head, shaft, grip, etc.)	\$12.00	Nëse prodhimi i një shkopi golfi kushton 25\$
Labor (0.5 hours at \$9.00/hr)	\$ 4.50	dhe ju e shitni për 30\$, atëher margjina e
Overhead (rent, insurance, utilities, taxes, etc.)	\$ 8.50	fitimit do të jetë 5\$.
Total	\$25.00	

- ▶ Pika e rentabilitetit = $\frac{\text{investimi fillestar}}{\text{Margjinen e fitimit Neto}} = \frac{100,000\$}{5\$} = 20,000 \text{ shkopinj golfi.}$

Zhvillimi I një “Business Case”

- ▶ **Kthimi I investimit** - është një tregues i performancës financiare të kompanisë. Nga pikëpamja e menaxhimit të projektit, kthimi I investimit siguron një masë të vlerës së pritshme ose pranuar nga një alternativë e caktuar apo projekt. Në qoftë se një alternativë projekti, për shembull, pritet të kushtojë 100.000 \$, por ofron 115.000 \$ në përfitimet e pritura, kthimi i investimit të saj do të jetë:
- ▶ Kthimi i investimit të projektit =
$$\frac{\text{Përfitimet totale të pritshme} - \text{kostot totale të pritshme}}{\text{kostot totale të pritshme}} = \frac{115,000\$ - 100,000\$}{100,000\$} = 15\%$$
- ▶ **Vlera aktuale Neto (NPV)** - fokusohet në vlerën në kohë të parasë.

	<i>Year 0</i>	<i>Year 1</i>	<i>Year 2</i>	<i>Year 3</i>	<i>Year 4</i>
Total Cash Inflows	\$0	\$150,000	\$200,000	\$250,000	\$300,000
Total Cash Outflows	\$200,000	\$85,000	\$125,000	\$150,000	\$200,000
Net Cash Flow	(\$200,000)	\$65,000	\$75,000	\$100,000	\$100,000

Zhvillimi i një “Business Case”

- ▶ NPV llogaritet më formulën:
$$NPV = -I_0 + \sum \left(\frac{\text{Net Cash Flow}}{(1+r)^t} \right)$$
 - ▶ *I* - kostoja totale (ose investimi) në projekt; *r* - norma e skontimit; *t* - periudha kohore.
- ▶ Në qoftë se ne përdorim një normë skontimi prej 8 për qind, ne mund të zbresim rrjedhën neto të parasë për secilën periudhë.

<i>Time Period</i>	<i>Calculation</i>	<i>Discounted Cash Flow</i>
Year 0	(\$200,000)	(\$200,000)
Year 1	$\$65,000 \div (1 + .08)^1$	\$60,185
Year 2	$\$75,000 \div (1 + .08)^2$	\$64,300
Year 3	$\$100,000 \div (1 + .08)^3$	\$79,383
Year 4	$\$100,000 \div (1 + .08)^4$	\$73,503
Net Present Value (NPV)		\$77,371

- ▶ Kjo alternativë do të ishte e pranueshëm për shkak se një NPV prej \$ 77,371 është pozitive.

Zhvillimi i një “Bussiness Case”

- Modeli I notimit siguron një metodë për të krahasuar alternativat apo projektet bazuar në një rezultat të ponderuar. Gjithashtu lejojnë për të kuantifikuar përfitime jo materiale ose për alternativa të ndryshme duke përdorur kritere të shumta.

$$\text{Total Score} = \sum_{i=1}^n w_i c_i \quad \text{► Ku } w_i \text{ – pesha e kriterit; } c_i \text{ – notimi i kriteri; } 0 \leq w_i \leq 1$$

- Në tabelen e mëposhtme do të paraqitet llogaritja e vlerës përmes pikëve.

<i>Criterion</i>		<i>Weight</i>	<i>Alternative A</i>	<i>Alternative B</i>	<i>Alternative C</i>
Financial	ROI	15%	2	4	10
	Payback	10%	3	5	10
	NPV	15%	2	4	10
Organizational	Alignment with strategic objectives	10%	3	5	8
	Likelihood of achieving project’s MOV	10%	2	6	9
Project	Availability of skilled team members	5%	5	5	4
	Maintainability	5%	4	6	7
	Time to develop	5%	5	7	6
	Risk	5%	3	5	5
External	Customer satisfaction	10%	2	4	9
	Increased market share	10%	2	5	8
Total Score		100%	2.65	4.85	8.50


PËRZGJEDHJA DHE APROVIMI I PROJEKTIT

- ▶ Objektivi i studimit të biznesit është për të marrë miratimin dhe financimin për një alternativë të propozuar.
- ▶ Megjithatë, një projekt i propozuar mund të duhet të konkurrojë kundër disa të tjerëve.
- ▶ Kriteret për zgjedhjen e një portofoli të projektit, të një sërë projektesh që një organizatë mund të financojë, janë shumë të ngjashme me analizën dhe përzgjedhjen e mëvonshme të alternativave të propozuara të projektit.
- ▶ **Procesi i zgjedhjes së projektit të TI-së** - Procesi i përzgjedhjes përcakton se cilat projekte do të financohen në një periudhë të dhënë. Në mënyrë që të pastrohen projektet të cilat kanë pak shanse për tu miratuar, shumë organizata përdorin një proces të shqyrtimit fillestar në të cilat studimet e biznesit që dorëzohen për rishikim janë krahasuar me një sërë standardesh organizative që të përshkruajnë kërkesat minimale.
- ▶ Projektet që plotësojnë kërkesat minimale janë përcjellë pastaj në një komitet vendimmarrës të menaxherëve të lartë të cilët kanë autoritetin për të miratuar dhe për të siguruar burimet e nevojshme për të mbështetur projektin.
- ▶ Projektet e përzgjedhura duhet pastaj të caktohet një menaxher projekti i cili zgjedh ekipin e projektit dhe pastaj zhvillon një skemë të projektit dhe planin e detajuar.

PËRZGJEDHJA DHE APROVIMI I PROJEKTIT

- ▶ **Vendimi për zgjedhjen e projektit** - Edhe pse çdo propozim projekt duhet të vlerësohet në aspektin e vlerës së tij në organizatë, është e rëndësishme që të përsëris se projektet nuk duhet të ndërmerret për hir të teknologjisë.
- ▶ **Vendimi për të miratuar një projekt** kërkon një numër të kushteve të plotësohen:
 - ▶ Projekti duhet të pasqyroj direkt strategjitë dhe qëllimet e organizatës.
 - ▶ Projekti duhet të sigurojë vlera të matshme organizative që mund të verifikohet në përfundimin e projektit.
 - ▶ Zgjedhja e një projekti duhet të bazohet në shumëllojshmërinë e masave që përfshijnë:
 - ▶ Kostot e prekshme dhe përfitimet
 - ▶ Kostot e paprekshme dhe përfitimet
 - ▶ Nivele të ndryshme në të gjithë organizatën

PËRZGJEDHJA DHE APROVIMI I PROJEKTIT



KONCEPTIMI DHE INICIALIZIMI I PROJEKTËVE TË TI-SË

► **PYETJE PËR KËTË KAPITULL?**